



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MEDHA

VENDIM

Nr 1 Datë 26.03.2019

Për

Shqyrtimin e Miratimin e projektit të zbatimit mbi “Reabilitimin e digës së rezervuarit Tapizë”.

Në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, nenit 9 si dhe “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e tij të datës 26.03.2019, mori në shqyrtim materialin e arrdhur nga Bashkia Krujë (Drejtoria e Planifikimitdhë Kontrollit të Zhvillimit të Territorit) në lidhje me projekt zbatimin mbi “Reabilitimin e digës së rezervuarit Tapizë”. Projekti është hartuar nga firma “Angerba” shpk. Materiali u prezantua nga përfaqësuesit e firmës “Angerba” shpk, ing. Burhan Hafizi dhe ing. Rezart Zgjanjolli.

Rezervuari i Tapizës është ndërtuar në vitin 1964 me volum uji $7,0 \text{ miljon m}^3$ ku ujiten 1700 ha të fshatit Nikel. Mbushja me uje e rezervuarit bëhet pjesërisht nga pellgu shimbledhës dhe pjesërisht me kanal ushqyes që merr ujë nga Lumi i Zezës.

Nisur nga kushtet topografike të kupës për krijimin e rezervuarit, janë ndërtuar tri diga; Diga nr.1 gjatësi 600ml dhe lartësi 12 m: Diga nr. 2 gjatësi 130 dhe lartësi 3.m dhe Diga nr.3 gjatësi 420 ml dhe lartesi 9 m.

Përmendim se me gjithë insistimin nuk ka qenë e mundur të gjëndet asnjë dokument i projektit të digës ekzistuese.

Në digat e këtij rezervuari sidomos në digën nr.1 dhe në digën nr.3 ka patur rrëshqitje si në skarpatën e sipërme ashtu dhe në atë të poshtmen.

Nga grupi i projektimit është kryer projekti për riparimin e digave. Projekti që po shqyrtohet është përgatitur sipas vëretjeve që bëri KKDM në mbledhjen e datës 31.01.2019 si dhe rekomandimeve që u dhanë gjatë verifikimit që u krye në vënd nga një grup specialistësh.

Në zbatim të këtyre detyrave nga grupi i projektimit u kryen studimet plotësuese gjeologjike hidrogeologjike dhe llogaritjet përkatëse. Mbi këtë bazë u hartuan edhe projektet e zbatimit të riparimit të digave. Simbas projektit të ripunuar:

- Ulet kurora e digës deri në kuotën 52.60
- Hiqet pjesa e rrëshqitur në digë si në skarpatën e sipërme ashtu dhe në atë të poshtme.
- Bëhet mbushja me dhera e skarpatave dhe në fundin e secilës vendoset nga një kondrabankinë e mbushur me gurë dhe një filtër zhavori.
- Zgjerohet baza e shkarkuesit nga 4m deri në 7m
- Në kurorë vëndoset një parapet me lartësi 1.0 m
- Volumi i ujit në rezervuar mbetet 6650.000m³

Pas prezantimit të projekt-zbatimit, dëgjimit të opinionit dhe propozimeve të Këshillit Teknik të Përherershëm të Digave dhe analizës dhe diskutimeve të anëtarëve, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha :

V E N D O S I

Të miratojë projekt zbatimin mbi “Reabilitimin e digës së rezervuarit Tapizë” me kurorë digë në kuotën 52.60m dhe parapet në kuotën 53.60m duke mbajtur parasysh sa vijon:

1. Ujëlëshuesi ekzistues të paiset me porta metalike në kullën e hyrjes dhe pjesa tjetër ekzistuese e cila do vazhdojë të ngelet pa presion, të riparohet nga brënda për të mos patur carje për të mos lejuar largim të grimcave të dheut të digës nëpër të carat ekzistuese që mund të jenë në ujëlëshues.
2. Në fund të skarpatave para mbushjes me zhavor e gurë të vëndoset gjeotekstil.
3. Të kryhet llogaritja e skarpatës së sipërme me zbrazjen e menjëherëshme të ujit në rezervuar. Në funksion të rezultateve të bëhet korigjimi i projektit.
4. Në projekt zbatimi të jepen të gjitha detajet, prerjet, përmasat, skarpatat, kuotat e niveleve të ujit etj, si dhe specifikimet teknike për zbatimin e punimeve.
Të gjitha këto duke mbajtur parasysh vecantinë e punimeve të riparimit.
5. Në shënimet teknike për shfrytëzuesin duhet të kërkohet të bëhet vrojtimi dhe monitorimi i digës në cdo 10 ditë, gjatë mbushjes së parë dhe deri në 5 muaj mbas saj. Mbësaj periudhe vrojtimi mund të rrallohet. Të dhënë e vrojtimeve të plotësojnë dokumentacionin teknik të digës.
6. Mbësaj përfundimit të punimeve, ndalohet kalimi i mjeteve motorike në kurorë të digës.
7. Në zbatim të nenit 4 VKM nr.278, datë 8.05.2003 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të KKDM dhe KTPD” pika 3b, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha miraton grupin ose specialistin e propozuar nga administratori i digës për drejtimin e punimeve.

Për plotësimin e kësaj kërkese, rekomandojmë të bëhet tender parakualifikues.

8. Në zbatim pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 20 të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave" të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004, rekomandojmë pronarit dhe shfrytëzuesit të digës që mbikqyrja e punimeve të kryhet nga grupei që ka hartuar projektin e riparimit të digës.

Inxh.Maksim Muci
KRYETAR